

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

7 mars 2014, Prizren

Komunikatë #11

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Ekzekutivi të hartoj planin për promovimin e vlerave tradicionale të Prizrenit

“EC Ma Ndryshe” në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” ka përcjellë nga afër emërimin e drejtorëve të rinj të qeverisë komunale, puna e përditshme e të cilëve lidhet me urbanizmin, ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe promovimin e turizmit dhe të zhvillimit ekonomik.

Meqenëse kryetari i Komunës së Prizrenit ka emëruar drejtorë të rinj në krye të Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, do të ishte e udhës që këta zyrtarë të lartë komunal, krahas planit të tyre të punës, të hartojnë edhe një plan të përbashkët për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të Prizrenit, në funksion të zhvillimit të turizmit dhe të ekonomisë.

Qeverisja lokale në Prizren, asnjë herë deri tani, nuk ka funksionuar me logjikën e planifikimit dhe menaxhimit të integruar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Koordinimi mes drejtorive të kulturës, turizmit dhe zhvillimit ekonomik, urbanizmit dhe inspektoratit është i domosdoshëm për ndalimin e degradimit urban të qytetit dhe shfrytëzimin e pasurisë kulturore për nevoja të zhvillimit lokal. Këto katër drejtori duhet që në afatin më të shkurtër t’i koordinojnë veprimet e tyre në kuadër të një plani të veprimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit.

Bazat e këtij koordinimi mes drejtorive janë të vendosura në Planin për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit, dokument i miratuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2008. Pjesë përbërëse e këtij plani të përbashkët të veprimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e Qendrës Historike do të duhej të jetë edhe një proces i vlerësimit të gjendjes, për të konstatuar nivelin e degradimit të trashëgimisë kulturore dhe strukturës urbane të Qendrës Historike. Në të njëjtën kohë, ky plan duhet të jetë në përputhje me kornizën qendrore ligjore, si dhe të përfshijë kontributin e institucioneve qendrore të shtetit, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të pavarur dhe grupeve të komunitetit.

Duke i marrë parasysh ato që u thanë më lartë, rekomandohen drejtorët e rinj të qeverisë lokale të Prizrenit që të hartojnë planet për drejtoritë e tyre përkatëse dhe një plan të përbashkët veprimi për ruajtjen dhe promovimin e Prizrenit, si destinacion turistik;

Gjithashtu ata rekomandohen që gjatë këtij procesi të bashkëpunojnë ngushtë me akterët relevantë të këtyre fushave;

EC Ma Ndryshe kërkon që drejtorët brenda tre muajve nga marrja e detyrës ta kenë planin e gatshëm dhe të vihen në zbatim të tij, me qëllim të sigurimit të një ambienti më të mirë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe ofrimit të një mirëqenieje më të mirë për qytetarët.

“EC Ma Ndryshe” në korrik të vitit 2013 ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nevoja për mbikëqyrjen e zhvillimeve në sektorin e urbanizimit ka rrjedhë si pasojë e zhvillimeve të shumta negative gjatë periudhës së pasluftës dhe tranzicionit që janë manifestuar me degradimin urban dhe planifikimin e pabalancuar hapësinor. Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

Me nderime,

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &

Perandori Dioklecian 14, Kati V, 10000 Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo